

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektvendim “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Konsultimi elektronik për projektvendimin “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit” u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditë pune, dhe konkretisht 27.02.2023 – 25.03.2023.

3. Metoda e konsultimit

Metoda e përdorur për konsultimin publik:

- *Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, RENJK;*

Gjithashtu, linku që i përket konsultimit publik të projektvendimit “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit”, është vendosur edhe në Programin e Transparencës së Inspektoratit Qendror¹ në kategorinë “Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP”. Gjatë periudhës 27.02.2023 – 25.03.2023 nuk janë përcjellë komente përmes RENJK, apo në rrugë postare në adresën e Inspektoratit Qendror, si dhe në adresën e e-mailit të koordinators për njoftimin dhe konsultimin publik. Lidhur me këtë projektvendim nuk janë zhvilluar takime apo tryeza konsultimi sa i përket nismës për hartimin e tij, duke qenë se vjen si detyrim i përcaktuar në pikën 1, të nenit 56, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Palët e interesit të përfshira

Gjatë procesit të konsultimit publik nuk janë përfshirë palë të treta. Hartimi i projektvendimit “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit” është realizuar nga bashkërendimi i punës midis strukturave përkatëse të Inspektoratit Qendror.

5. Pasqyra e komenteve të pranuarra me arsyetimin e komenteve të pranuarra/refuzuara

Nga konsultimi publik i kryer në Regjistrin elektronik në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk ka pasur komente apo propozime të caktuara mbi përmbajtjen e projektvendimit.

¹ www.insq.gov.al